



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Persona të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.
2. Obligohet Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, nenit 8 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Krugës Rajonale R102 Klinë-Skenderaj-Polluzhë, Zonat Kadastrale: Klinë e Epërme, Klinë e Mesme, Klinë e Poshtme, Skenderaj, Novosellë, Polac i Vjetër, Krushevc, Polac i Ri, Llaushë, Komuna Skenderaj dhe Zona Kadastrale Polluzhë, Komuna Drenas, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 13/2011 për Zbatimin e Metodave dhe Kriteve Teknike të Vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 34,600.00 (tridhjetekatërmijë e gjashtëqind) euro, për mbulimin e shpenzimeve të Sekretarisë dhe Komisionit Qeveritar për njohjen dhe Verifikimin e statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nënprogrami Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100 dhe bartën në Zyrën për Veteranët e Luftës\Zyra e Kryeministrit, Kodi buxhetor 10700 në kategorinë mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeveris



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.04/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Obligohet Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i themeluar me Vendim të Qeverisë nr. 03/58 datë 27 janar 2012, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendim të Qeverisë 06/103 datë 21 nëntor 2012, që deri më datë 20 maj 2016 ta përmbyllë procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe ta dërgojë në Qeveri Raportin përfundimtar me të gjitha dokumentet përcjellëse.
2. Mandati i këtij Komisioni përfundon me datë 20 maj 2016.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ekstradim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Hungarisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Drejtësisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme Grupi Ndërministror).
2. Grupit Ndërministror udhëhiqet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.
3. Grupi Ndërministror në përbërje të tij ka anëtarë Ministrat nga Ministrinë e Linjës, Avokatin e Popullit dhe përfaqësues nga Shoqëria Civile.

4. Grupi ka këtë përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| 4.1. Kryeministri i Republikës së Kosovës, | Kryesues; |
| 4.2. Avokati i Popullit, | anëtar; |
| 4.3. Përfaqësuesi nga Shoqëria Civile, | anëtar; |
| 4.4. Ministri i Punëve të Jashtme, | anëtar; |
| 4.5. Ministri i Integrimit Evropian, | anëtar; |
| 4.6. Ministri i Drejtësisë, | anëtar; |
| 4.7. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, | anëtar; |
| 4.8. Ministri i Punëve të Brendshme, | anëtar; |
| 4.9. Ministri i Financave, | anëtar; |
| 4.10. Ministri për Komunitete dhe Kthim, | anëtar; |
| 4.11. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, | anëtar; |
| 4.12. Ministri i Shëndetësisë, | anëtar; |
| 4.13. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, | anëtar; |
| 4.14. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, | anëtar; |
| 4.15. Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë, ZKM, | anëtar; |
| 4.16. Agjencia për Barazi Gjinore, ZKM, | anëtar; |
| 4.17. Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, ZKM, | anëtar; |
| 4.18. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, | anëtar; |
| 4.19. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale, | anëtar. |

5. Grupi Ndërmintor ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 5.1 Forcimi i koordinimit në fushën e të drejtave të njeriut të të gjitha ministrive dhe autoriteteve kompetente në Qeveri;
 - 5.2 Monitorimin e zbatimit të politikave dhe strategjive për të drejtat e njeriut në Kosovë;
 - 5.3 Raportimi para Kuvendit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës;
 - 5.4 Shkëmbimi i informatave e të dhënave dhe realizimi i rekomandimeve të përfshira në raportet e Këshillave kompetent dhe organeve tjera të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;
 - 5.5 Buxhetimi i të drejtave të njeriut dhe vendosja e politikave prioritare për të drejtat e njeriut;
 - 5.6 Dhënia e propozimeve për avancimin e kornizës ligjore në fushën e të drejtave të njeriut dhe propozimeve të tjera të rëndësishme për zhvillimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.
6. Grupi Ndërmintor miraton Rregulloren e vet të punës.
7. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë mandatohet që në bashkëpunim me institucionet tjera dhe shoqërinë civile të hartojnë termat e referencës për punën e Grupit Ndërmintorë të cilat miratohen në takimin e parë të Grupit.
8. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit do të shërbej si Sekretariat këtij mekanizmi.
9. Grupi Ndërmintor mblidhet të paktën tre herë në vit.
10. Sipas nevojës Kryesuesi fton institucionet relevante në takimin e Grupit Koordinues Ndërmintor për të Drejtat e Njeriut.
11. Zyra e Kryeministrit dhe Institucionet tjera kompetente obligohen për zbatimin e këtij vendimi.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Karta për Hapjen e të Dhënave në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike për koordinimin e punës për zbatimin e Kartës për hapjen e të dhënave përmes hartimit të një Plani Kombëtar të veprimit si dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të tjera që parashikojnë zhvillimin e kapaciteteve për institucionet publike përkitazi me obligimet për hapjen e të dhënave.
3. Ministri i Ministrisë së Administratës Publike themelon një grup punues gjithëpërfshirës të përberë nga institucionet publike, shoqëria civile si dhe palët e tjera të interesit, për përgatitjen e planit kombëtar të veprimit për hapjen e të dhënëve.
4. Plani i Veprimit Kombëtar për hapjen e të dhënëve përgatitet në baza vjetore nga Ministria e Administratës Publike.
5. Ministria e Administratës Publike përkatësisht Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) menaxhon portalin shtetëror të Republikës së Kosovës për hapjen e të dhënave (opendata.rks-gov.net). Të gjitha institucionet e administratës shtetërore duhet të kenë qasjen e tyre përkatëse në portal për publikimin e të dhënave në kuadër të fushë-veprimtarisë së tyre.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Qeverisë nr. 08/139 i datës 09.07.2013 dhe vendimi nr. 06/186 i datës 29.04.2014.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 15,884.33 euro për Zyrën e Presidentit për pagesen e Komisionit ad hoc të ekspertëve ndërkombëtar për vlerësimin e procesit të Demarkacionit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi. Mjetet financiare ndahen për mbulimin e shpenzimeve si në vijim:

1.1. Akomodimi	2,708.48 euro;
1.2. Shpenzimet e udhëtimit	2,675.85 euro;
1.3. Kompensimet e ekspertëve	10,500.00 euro.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nënprogrami Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100 dhe barten në Zyrën e Presidentit me kod organizativ 102, nën programi Zyra e Presidentit me kod 10500, në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Presidentit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.09/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/86 (29.04.2016)

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 12/86 i datës 29 prill 2016.
2. Në gjithë tekstin e Vendimit Nr. 12/86 fshihen dispozitat që kanë të bëjnë me Koordinatorin e Zyrës për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë.
3. Autorizohet Kryeministri që të emërojë Koordinatorin dhe të caktojë kompensimin për punën e Koordinatorit nga mjetet e ndara për Zyrën për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ QRK nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF)

1. KKPEPF është trup koordinues dhe monitorues i politikave dhe programeve për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve.
2. KKPEPF vendosë politikat dhe prioritetet programore për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës, monitoron situatën e punës së fëmijëve në vend dhe koordinon veprimet kundër saj, dhe për këtë qëllim:
 - 2.1. Ofron udhëzime për politikat dhe programet që synojnë eliminimin e punës së fëmijëve dhe përcakton fushat prioritare për programe të drejtpërdrejta që synojnë tërheqjen e menjëhershme të fëmijëve të përfshirë në format më të rrezikshme të punës dhe parandalimin e përfshirjes së fëmijëve të rrezikuar;
 - 2.2. Propozon ndryshim plotësimin e legjislacionit për eliminimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve;
 - 2.3. Përkrahë Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera përgjegjëse në përmbushjen e objektivave dhe standardeve të përcaktuara sipas konventave të BE-së dhe ONP-së në fushën e punës së fëmijëve;
3. KKPEPF përbëhet nga:
 - 3.1. Ministri i MPMS-së, Kryetar;
 - 3.2. Udhëheqësi i Shërbimeve Sociale-MPMS, nënkryetar;
 - 3.3. Zyra për Qeverisje të Mirë -ZKM, anëtar;
 - 3.4. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar;
 - 3.5. Ministria e Financave, anëtar;
 - 3.6. Ministria e Drejtësisë, anëtar;

- | | | |
|-------|--|---------|
| 3.7. | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, | anëtar; |
| 3.8. | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, | anëtar; |
| 3.9. | Ministria e Shëndetësisë, | anëtar; |
| 3.10. | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, | anëtar; |
| 3.11. | Departamenti i Punës-MPMS-së, | anëtar; |
| 3.12. | Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës-MPMS, | anëtar; |
| 3.13. | Policia e Kosovës – komunitet, | anëtar; |
| 3.14. | Këshilli Ekonomik Social KES, | anëtar; |
| 3.15. | Organizatat joqeveritare të përfaqësuara në Forumin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – tre anëtarë. | |
4. Ministrinë në KKPEPF përfaqësohen nga Drejtorët e Departamenteve apo udhëheqësit e divizioneve përkatëse që kanë fushëveprimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe caktohen nga udhëheqësit e institucioneve përkatëse.
 5. KKPEPF mund të ftojë në takimet e veta përfaqësues të organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe të këshillohet me ta.
 6. KKPEPF mund të themelojë nën-komitete të specializuara për fusha të ndryshme, grupe punuese për ekzekutimin e vendimeve dhe realizimin e detyrave programore.
 7. KKPEPF mban takim së paku dy herë (2) në vit, apo sipas nevojë kur kërkesa për takim iniciohet nga së paku pesë anëtarë të KKPEPF apo në rastet kur takimin e fton Kryetari i Komitetit.
 8. KKPEPF ka Sekretarinë, e cila siguron realizimin e aktiviteteve të përditshme dhe vepron në emër të Komitetit. Sekretaria caktohet nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes (DPSF) në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
 9. KKPEPF në afat prej gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi miraton Rregulloren e punës.
 10. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë 05/166 i datës 13.09.2005 për themelimin e KKPEPF.
 11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/87

Datë: 13.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Shëndetësisë për Informimin e Kabinetit qeveritar nga Ministri i Shëndetësisë, lidhur me të arriturat e deritanishme në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, dhe përgatitjet e deritanishme për mbledhjen e premieeve.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeveris